



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 329, Datë 14.12.2022

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 247, DATË 29.09.2022, PËR LICENICMIN E SHOQËRISË “BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX” SH.A. NË VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; dhe nenit 113 pika 3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 2061 prot., datë 12.12.2022, “Mbi depozitimin në ERE nga shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë – ALPEX” sh.a. të “Rregullores për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 247, datë 29.09.2022, vendosi të licencojë “Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.
- Në konstatimet e vendimit nr. 247/2022 të bordit të ERE u përcaktua se: *Duke qenë se Draft-Rregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.*
- Në vijim të kësaj detyre të lënë, shoqëria me shkresën nr. 966/7 prot., datë 25.11.2022 ka depozituar në ERE “Rregulloren për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm”, e hartuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave sensitive përsa i përket tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike.

- Në mbledhjen e bordit të datës 14.12.2022, u relatua informacioni me nr. 2061 prot., datë 12.12.2022, “Mbi depozitimin në ERE nga shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë - ALPEX” sh.a., të “Rregullores për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm”.
- Në vijim të sa më sipër vlerësohet ndryshimi i vendimit nr. 247, datë 29.09.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sh.a., në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike, për një afat 5 - vjeçar”, duke hequr paragrafin e shtatë të konstatimeve të tij, me përmbajtje si vijon:
Duke qenë se Draft-Rregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë vendimin nr. 247, datë 29.09.2022, si më poshtë:
- në faqen e dytë hiqet paragrafi i shtatë i konstatimeve të tij, me përmbajtje si vijon:
Duke qenë se Draft-Rregullorja për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit konfidencial dhe të brendshëm, e depozituar në ERE nuk është miratuar ende, vlerësohet që shoqëria ta depozitojë atë pas miratimit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI